



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryreministrit - Ured Premijera – Office of the Prime Ministe

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (në Shëndetësi) Nr. 02/2025- KUSHTET DHE
PROCEDURAT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SHËNDETËSORE
NË INSTITUCIONET PRIVATE**

Në mbështetje të nenit 25 dhe 42 të Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi (G.Z.Nr.13/07 MAJ 2013), nenin 11, nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nxjerrë:

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (në Shëndetësi) Nr. 02/2025- KUSHTET DHE
PROCEDURAT PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SHËNDETËSORE NË
INSTITUCIONET PRIVATE**

**Dispozitat e përgjithshme
Neni 1**

Qëllimi

Ky udhëzim administrativ përcakton kushtet e përgjithshme dhe specifike, për hapësirën, kuadrin profesional, pajisjet e nevojshme medicinale në institucionet shëndetësore jashtë-spitalore procedurat e licencimit për ofrimin e kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësore jashtë-spitalore.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ, vlejné për të gjitha institucionet private shëndetësore jashtë-spitalore.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1. BLIPSh (Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore) është organ administrativ për licencimin e institucioneve private të kujdesit shëndetësor (tani e tutje Bordi);
- 1.2. Licenca/vendimi për licencim-është dokument me shkrim i lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë me të cilin lejohet veprimtaria private e institucionit shëndetësor;
- 1.3. OPSHK-Oda e profesionistëve shëndetësor të Kosovës;
- 1.4 DLISH-Divizioni për licencim të institucioneve shëndetësore;
- 1.5 Institucioni shëndetsor privat jashtë-spitalor i licencuar është institucion që ofron shërbime shëndetësore ambulantore, diagnostikim, trajtim dhe rehabilitim;
- 1.6 IPSH-Institucioni privat shëndetësor;
- 1.7 BLPSH-Bordi për licencim të profesionistëve shëndetësor;
- 1.8 AKMRrSB-Agjencia e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;

1.9 Poliklinika-Institucion shëndetësor që ushtron së paku tri (3) veprimtari shëndetësore të përcaktuar sipas dispozitave të këtij udhëzimi administrativ;

1.10 AUV - Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë;

1.11 AKK- Asociacioni i Komunave të Kosovës

1.12 DCSLAISh - Departamenti për Cilësi, Siguri, Licencim dhe Akreditim të Institucioneve Shëndetësore

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin ashtu siç janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI I

PROCEDURAT PËR LICENCIM, OBLIGIMET DHE TAKSA ADMINISTRATIVE PËR INSTITUCIONET PRIVATE SHËNDETËSORE SPITALORE DHE JASHTË SPITALORE

Neni 4

Aplikimi për licencë

1. Personi juridik ose fizik bënë aplikimin për licencë përmes qasjes në modulën e aplikimit elektronik në ueb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Udhëzuesi për aplikim elektronik nga paragrafi 1 publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.

3. Institucioni që aplikon për veprimtari shtesë dhe ndërrim të lokacionit (adresës) i nënshtrohet procedurave të njëjta të aplikimit për licencim dhe taksës administrative të përcaktuar me këtë udhëzim administrative, vetëm për veprimtarit për të cilat ka qenë i licencuar.

4. Dokumentacioni i nevojshëm i aplikimit për licencimin e institucionit privat shëndetësor jashtë spitalor është:

4.1 Moduli i aplikimit elektronik në ueb faqja e Ministrisë së Shëndetësisë/Vegzat;

4.2 Statuti i institucionit shëndetësor;

4.3 Dokumentacioni identifikues për themeluesin, drejtorin e institucionit shëndetësor dhe kuadër profesional;

4.4 Licenca për kuadrin profesional dhe ID ;

4.5 Certifikata e regjistrimit të biznesit;

4.6 Pagesa e taksës administrative

4.7 pëlqimi sanitar me vlefshmëri të lëshuar nga Inspektorati sanitar.

4.8 Deklarata nën betim e aplikuesit për të gjitha të dhënat e ofruara;

4.9 Licenca, vendimi, njoftimi (lajmërimi) apo regjistrimi nga AMRrSB-për institucionet shëndetësore që aplikojnë rreze jonizuese dhe jo-jonizuese;

4.10. Formulari vetë-vlerësues i plotësuar nga vet aplikuesi.

Neni 5

Kuadri profesional

1. Kuadri profesional në institucionin privat shëndetësor të licencuar ofron shërbime shëndetësore nëse:

1.1 është i licencuar nga Ministria e Shëndetësisë/Odat e profesionistëve shëndetësor;

1.2 kuadri profesional/bashkëpunëtori profesional shtetas i huaj që ofron shërbime shëndetësor nëse i është i lejuar nga organi kompetent.

1.3 Bashkëpunor profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë me dëshmi përkatëse për lëmi të caktuara nga OPSH.

Neni 6

Themelimi i Institucionit Shëndetësor

1. Institucioni privat shëndetësor themelohet në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit për shëndetësi.

2. Personi fizik, juridik, subjektet tjera vendore dhe të huaja mund të themelojnë institucion privat shëndetësor në pajtim me kushtet e parapara me ligjin për shëndetësi, këtë udhëzim administrativ dhe aktet tjera juridike me legjislacionin në fuqi.

Neni 7

Obligimet e institucionit privat shëndetësor

1. Institucioni privat shëndetësor jashtë spitalor:

1.1 Të evidentojë, të ruajë dokumentacionin dhe regjistrat mjekësor sipas legjislacionit në fuqi;

1.2 Të siguroj kuadrin profesional të nevojshëm sipas llojit së institucionit shëndetësor sipas dispozitave ligjore në fuqi.

1.3 Të siguroj zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me metodat dhe procedurat për kontrollin, ruajtjen, shpërndarjen dhe administrimin e barërave;

1.4 Menaxhimin e mbeturinave medicinale sipas dispozitave në fuqi.

1.5 Të zbatoj imunoprofilaksën e obliguar dhe fushatat e imunizimit plotësues;

1.6 Të bëhet plotësimi i recetave shëndetësore dhe dokumenteve shëndetësore sipa dispozitave ligjore në fuqi;

1.7 Të informojë përmes formës elektronike për shuarje të institucionit shtimit të procedurave mjekësore, nderprerjës së përkohshme të veprimtarisë shëndetësore, plotësimin apo largimin e personelit shëndetësor, ndërsa për institucionet të cilat nuk janë të licencuara përmes modulit elektronik bëhet përmes arkivës në Ministri të Shëndetësisë.

2. Institucioni privat shëndetësor obligohet që në vend të dukshëm të vendosë:

2.1 Licencën;

2.2 Orarin e punës;

2.3 Listën e shërbimeve me çmime;

2.4 Kartën e të drejtave dhe përgjegjësisë të pacientit;

2.5 Numrin e linjës telefonike për ankesat e qytetarëve;

2.6 Shenjën për ndalim të pirjes së duhanit;

2.7 Kutinë e ankesave/rekomandimeve.

Neni 8 **Formulari i vlerësimit**

1. Formulari i vlerësimit të kushteve, hapësirës dhe paisjeve mjekësore të institucioneve private shëndetësore është unik dhe është pjesë e modulit elektronik dhe plotësohet nga vetë aplikuesi.

2. Formulari i vlerësimit është pjesë e modulit për aplikimin e Institucioneve Private Shëndetësore në web faqe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe plotësohet nga aplikuesi.

Neni 9 **Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore**

1. Bordi është organ i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe përbëhet nga pesë (5) anëtarë:

1.1 Përfaqësuesi nga MSH;

1.2 Jurist nga MSh;

1.3 Përfaqësues nga OPSh-ve;

1.4 Përfaqësues nga AKK;

1.5 Përfaqësues nga DCSLAISH;

Neni 10 **Mandati i Bordit**

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit emërohen me afat kohor tre (3) vjeçar me mundësi vazhdimi.

2. Mandati i anëtarit të Bordit përfundon në këto raste:

2.1 Pas skadimit të mandatit;

2.2. Pas dhënies së dorëheqjes me shkrim;

2.3 Në rast të mospërbushjes së obligimeve të përcaktuara me këtë udhëzim administrativ, rasteve të shkeljeve ligjore apo disiplinore dhe rasteve të konfliktit të interesit.

Neni 11 **Kompetencat e Bordit**

1. Bordi shqyrton dokumentacionin e institucioneve private shëndetësore për licencim, ndryshim të lokacionit (adresës), veprimtarisë shtesë, ndërrimit të emrit të institucionit shëndetësor, transferimit të licencës, pezullimit të licencës dhe atë jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas pranimi të dokumentacionit nga DLISH.

2. Licencon, refuzon, pezullon, shfuqizon, shuan dhe revokon licencën e institucionit privat të kujdesit shëndetësor.

3. Licencon institucionin në rast të plotësimit të kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

4. Refuzon kërkesën e aplikuesit për licencim në rast të mos plotësimit të kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

5. Pezullon licencën nëse konstatohet nga organi kompetent se institucioni i licencuar ka dhënë deklaratë jo të saktë si dhe kur vepron në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

6. Shfuqizon vendimin për pezullim të licencës kur konstatohet nga organi kompetent se institucioni shëndetësor i ka plotësuar kushtet dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

7. Shfuqizon ose pezullon licencën e institucionit privat shëndetësor në rast të inicimit të procedurës për shfuqizim/pezullim nga Ministri/Inspektorati Shëndetësor ose organi kompetent.

8. Aprovon kërkesën për shuarje të një ose me shumë veprimtari shëndetësore të institucionit shëndetësor të licencuar vetëm në ato raste kur institucion bënë kërkesën me vetëdëshirë dhe nuk ka obligime të pa kryera ndaj Ministrisë së Shëndetësisë.

9. Revokon licencën e institucionit privat shëndetësor në rast kur me raport të Inspektoratit shëndetësor konstatohen shkelje të rënda ose mospërbushja e kriterëve sipas deklaramit me rastin e aplikimit.

10. Aprovon kërkesën për ndryshim të emrit të insitucionit.

11. Transferimi i licencës nga një subjekt në subjekt tjetër mund të bëhet vetëm në ato raste kur ka pajtueshmëri të dëshmuar në mes subjekteve dhe kur nuk ka obligime të pa kryera ndaj Ministrisë së Shëndetësisë.

12. Licenca mund të transferohet nga një themelues në themelues tjetër, nëse me rastin e aplikimit për licencim themeluesit kanë qenë bashkëthemelues të institucionit.

13. Raporton për Ministrin në afate periodike.
14. Nxjerr rregulloren e brendshme të punës.
15. Bordi duhet të ketë sekretarin teknike.
16. Shyrton çështje tjera të cilat kanë të bëjnë me institucionet private shëndetësore.
17. Bordi nxjerr vendim/licencë për çështjet nga paragraf 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij neni.
18. Në rast se nuk është rregulluar ndryshe me këtë Udhëzim Administrativ, autoriteti kompetent zbaton procedurën e përgjithshme administrative.

Neni 12

Lëshimi i licencës

1. Licenca e institucionit privat shëndetësor nënshkruhet nga Kryesuesi i Bordit dhe Ministri.
2. Licenca ka datën e lëshimit dhe datën e skadimit.
3. Licenca është e vlefshme për periudhën pesë (5) vjeçare.
4. Licenca mund të jetë objekt i transferimit nga një subjekt në subjektin tjetër.
5. Çdo plotësim/ndryshim i veprimtarisë së institucionit shëndetësor të licencuar vlenë deri në datën e skadimit të licencës.

Neni 13

Detyrat e DLISH

1. Pas licencimit të Institucionit shëndetësor themeluesi do të informohet përmes sistemit elektronik.
2. DLISH bënë regjistrimin e institucioneve private shëndetësore që kanë aplikuar, licencuar, refuzuar, revokuar, pezulluar dhe anulimin e licencave.
3. Të dhënat e institucioneve private shëndetësore të licencuara i dërgohen Divizionit të Informimit për publikim në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.
4. Aprovon/refuzon ose dërgon në bord kërkesat për shtim/largim dhe ndryshim të orarit të personelit shëndetësor.

Neni 14

Inspektimi, mbikëqyrja dhe monitorimi

1. Inspektimi dhe mbikëqyrja i institucioneve private shëndetësore bëhet nga organet ispektuese për fushat e caktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.
2. Monitorimi i institucioneve private shëndetësore bëhet nga DLISH.

Neni 15

Procedura e ankesës

1. Komisionin për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve të institucioneve private shëndetësore është organ i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë:

1.1 Përfaqësuesi i MSH;

1.2 Jurist nga MSH;

1.3 Përfaqësues nga OPSH-të.

2. Kundër vendimit të Bordit, aplikuesi i institucioni privat shëndetësor ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve të institucioneve private shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë.

3. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit të ankesave emërohen me afat kohor dy (2) vjeçar me mundësi vazhdimi.

4. Afati për ankesë është tridhjetë (30) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

5. Komisioni për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve dhe institucionit shëndetësor shqyrton ankesën brenda 30 ditëve.

Neni 16

Kompensimi

Bordi, Komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe sekretaria teknike kompensohen sipas akteve juridike në fuqi.

Neni 17

Pagesa e taksës administrative

1. Institucioni privat shëndetësor obligohet të paguajë taksën administrative për aplikim, licencim, veprimtari shtesë, ndërrim të lokacionit (adresës), të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ.

2. Taksa administrative e paguar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk kthehet.

3. Taksa për licencë paguhet jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas datës së aprovimit të kërkesës së aplikuesit nga Bordi.

4. Taksat paguhën sipas shtojcës dy (2) të këtij Udhëzimi administrative.

5. DLA në rast se nuk paguhet në afat të përcaktuar me paragrafin 3 të këtij Neni i dergon listen Inspektoratit Shëndetësor.

KAPITULLI II

KUSHTET PËR PUNË SA I PËRKET HAPSIRËS, KUADRIT PROFESIONAL, PAJISJEVE MEDICINALE TË INSTITUCIONEVE PRIVATE SHËNDETËSORE JASHTË-SPITALORE

Neni 18

Kushtet e përgjithshme

1. Institucioni shëndetësor që ushtron veprimtarinë private shëndetësore jashtë-spitalore obligohet të plotësoj kushtet:

1.1 Institucioni shëndetësore siguron qasje të lehtë për personat me aftësi të kufizuara;

1.2 Lartësia e mureve të objektit të jetë së paku 250 cm;

1.3 Ngrohje, në përputhje me standardet teknike dhe ekologjike;

1.4 Institucioni shëndetësor më një veprimtari të ketë hapësirën e pritores për pacientë së paku 9 m², me këndin për informim, karrigë dhe tavolinë;

1.5 Institucioni shëndetësor me dy (2) veprimtari shëndetësore, të ketë hapësirën e pritores së paku 12 m² me këndin për informim, karrigë dhe tavolinë;

1.6 Poliklinika me tri veprimtari të ketë hapësirën e pritores të përbashkët, por jo më e vogël se 16m² dhe për çdo veprimtari shtesë të ketë së paku 4m² të ketë tre (3) tualete , një nga tualet të jetë dedikuar vetëm për persona me aftësi të kufizuar;

1.7 Qasja e pacientëve për tualet të jetë nga pritortja;

1.8 Institucioni shëndetësor me një veprimtari shëndetësore të ketë së paku një (1) tualet.

1.9 Institucioni shëndetësore me dy (2) veprimtari shëndetësore të ketë së paku dy tualete një nga tualetet të jetë dedikuar edhe për persona me aftësi të kufizuar;

1.10 Labororet duhet të posedojnë së paku dy (2) tualete.

1.11 Ordinanca të ketë lavaman me ujë të ngrohtë;

1.12 Dyshemeja të jetë nga materiali i cili mundëson dezinfektimin dhe pastrimin e lehtë;

1.13 Muret e hapësirave të jenë të rrafshëta, të lëmuara, rezistente ndaj pastrimit të shpeshtë;

1.14 Dera e hyrjes në institucion të ketë gjerësi së paku 110cm;

1.15 Dyert tjera të kenë gjerësi prej 80-100 cm dhe të mos kenë prag;

1.16 Kyçje në rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, rrymës elektrike dhe mbrojtjes kundër zjarrit sipas standardeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;

- 1.17 Të ketë burim alternativ të ujit ose të sigurohet në mënyra të tjera, sasia e nevojshme e ujit për ushtrimin e papenguar të veprimtarisë shëndetësore;
- 1.18 Të posedon pajisje të teknologjisë informative;
- 1.19 Hapësira e punës të ketë ndriçim dhe ventilim;
- 1.20 Dritaret të mundësojnë depërtimin e dritës dhe qasje të lehtë për pastrim;
- 1.21 Burim alternativ të energjisë elektrike;
- 1.22 Kompletin për anti-shok terapi dhe udhëzuesin për përdorim;
- 1.23 Preparatet dhe materiet e ndezshme të ruhen në ambalazh origjinal në hapësirë të mbyllur apo dollap të veçantë sipas legjislacionit në fuqi;
- 1.24 Hapësirat e institucionit shëndetësor shfrytëzohen vetëm për ofrimin e shërbimeve shëndetësore;
- 1.25 Poliklinika punon së paku pesë (5) ditë të javës dhe jo më pak se katër orë (4) në ditë për secilën veprimtari në kuadër të poliklinikës;
- 1.26 Institucionet shëndetësore me një dhe dy veprimtari, jashtë spitalore të punojnë së paku tre (3) ditë të javës dhe jo më pak se katër (4) orë në ditë;
- 1.27 Institucioni shëndetësor gjatë gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore duhet të ketë prezent kuadrin profesional.

Neni 19

Ambulancë shëndetësore

1.Ambulanca shëndetësore përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe më së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezi lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventari:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermier/teknik mjekësor;

1.2.3 Karrigë për mjekun;

1.2.4 Karrigë për infermier/teknik mjekësor;

1.2.5 Varëse për rroba;

1.2.6 Shtrat dhe karriga pa mbështetëse me mekanizëm rrotullues për ekzaminim të pacientit;

1.2.7 Paravan;

1.2.8 Dollap për barna dhe instrumente;

1.2.9 Tavolinë për instrumente;

1.2.10 Shportë për mbeturina medicinale dhe shportë për mbeturina tjera;

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Shpatulla për një përdorim;

1.3.5 Dorëza për një përdorim;

1.3.6 Fasha;

1.3.7 Peshore;

1.3.8 Matës të gjatësisë;

1.3.9 Enë metalike;

1.3.10 Enë metalike me kapak për instrumente;

1.3.11 Enën metalike me kapak për tamponë;

1.3.12 Veshkore;

1.3.13 Boca me oksigjen;

1.3.14 Llambë tavoline;

1.3.15 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.16 Llambë të dorës me bateri;

1.3.17 Glikometër;

1.3.18 Lidhësen e Esmarch-ut;

- 1.3.19 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;
- 1.3.20 Telefon;
- 1.3.21 Frigorifer;
- 1.3.22 Mbajtës infuzioni;
- 1.3.23 EKG;
- 1.3.24 Defribilator;
- 1.3.25 Puls-oksimetër;
- 1.3.26 Spekulum për hund
- 1.3.27 Otoskop;
- 1.3.28 Pasqyrë e ballit;
- 1.3.29 Oftalmoskop;
- 1.3.30 Tabelë për kontrollin e shikimit;
- 1.3.31 Aparat për sterilizim;
- 1.3.32 Negatoskop;
- 1.3.33 Qekani për refleksë;
- 1.3.34 Mjete për imobilizim të përkohshëm;
- 1.3.35 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.
- 1.3.36 Peakfloëmetër;
- 1.4 Personeli:
 - 1.4.1 Doktor i mjekësisë ose specialistë të cilët nuk janë të përfshirë në këtë udhëzim.
 - 1.4.2 Infermier/teknik mjekësor.

Neni 20

Ambulancë specialistike e mjekësisë familjare

1. Ambulanca specialistike e mjekësisë familjare përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

- 1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermier/teknik mjekësor;

1.2.3 Karrigë për mjekun;

1.2.4 Karrigë për infermiere/teknik mjekësor;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barna dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale dhe shportë për mbeturina tjera;

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Shpatulla për një përdorim;

1.3.5 Dorëza, maska për një përdorim;

1.3.6 Fasha, gaza sterile;

1.3.7 Peshore;

1.3.8 Matës të gjatësisë;

1.3.9 Veshkore;

- 1.3.10 Negatoskop;
- 1.3.11 Boca me oksigjen;
- 1.3.12 Llambë tavoline;
- 1.3.13 Thjerrëz zmadhuese;
- 1.3.14 Llambë të dorës me bateri;
- 1.3.15 Glikometër;
- 1.3.16 Lidhësen e Esmarch-ut;
- 1.3.17 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;
- 1.3.18 Telefon;
- 1.3.19 EKG;
- 1.3.20 Defribilator;
- 1.3.21 Pulsoksimetër;
- 1.3.22 Peakfloëmetër;
- 1.3.23 Otoskop;
- 1.3.24 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime;
- 1.3.25 Oftalmoskop;
- 1.3.26 Tabelë për kontrollin e shikimit;
- 1.3.27 Aparat për sterilizim;
- 1.3.28 Frigorifer;
- 1.3.29 Mbajtës infuzioni;
- 1.3.30 Enë metalike;
- 1.3.31 Enë metalike me kapak për instrumente;
- 1.3.32 Enë metalike me kapak për tamponë;
- 1.4 Personeli:
 - 1.4.1 Specialist i Mjekësisë Familjare;

1.4.2 një (1) Infermier/teknik mjekësor.

Neni 21

Ambulancë stomatologjike

1.Ambulanca stomatologjike përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira prej 12m², ku kontrollohen dhe trajtohen pacientët është e paraparë vetëm për një karrige stomatologjike dhe aparaturë tjetër përcjellëse;

1.1.2 Hapësira për 2 karrige stomatologjike në një ambulancë të jetë së paku 20m².

1.2 Pajisje bazike dhe material i nevojshëm:

1.2.1 Dorëza dhe maska për një përdorim;

1.2.2 Dorëza sterile;

1.2.3 Fasha dhe gaza sterile;

1.2.4 Alkool 70% së paku një litër për dezinfektim;

1.2.5 Antiseptik për instrumente;

1.2.6 Jod për dezinfektim;

1.2.7 Chlorhexidin apo HypocloridNa për irigimin e kanaleve të rrënjëve të infektuar;

1.2.8 Tretje fiziologjike;

1.2.9 Set metalik (Tasne) me instrumente për vizite stomatologjike (së paku 10 sete);

1.2.10 Enë me kapak për instrumente; (nëse ka sterilizator e jo autoklavë);

1.2.11 Enë metalike me kapak për tamponë-dobosh (nëse ka sterilizator e jo autoklavë);

1.2.12 Ujë të distiluar (nëse ka autoklavë);

1.2.13 Paketues të instrumenteve (nëse ka autoklavë);

1.2.14 Gota për një përdorim;

1.2.15 Aspirator për një përdorim;

1.2.16 Përparëse të pacientit për një përdorim;

1.2.17 Enë për instrumente të papastërta;

1.2.18 Glikometër;

1.2.19 Stetoskop;

1.2.20 Matës të shtypjes së gjakut;

1.2.21 Boca me oksigjen;

1.2.22 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.2.23 Telefon;

1.2.24 Aparat për sterilizim;

1.2.25 Ambu maskë;

1.2.26 Veshkore;

1.2.27 Negatoskop;

1.2.28 Termometër për matjen e temperaturës trupore;

1.2.31 Llambë të dorës me bateri;

1.2.32 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.2.33 Frigorifer;

1.2.34 Enë apo vendi për vendosjen e vaterollnave;

1.2.35 Pajisja për Oksidulin e Azotit perdorimi i të cilës bëhet sipas udhëzuesve dhe protokoleve përkatëse klinike*.

1.3. Pajisje dhe inventar:

1.3.1 Karrigë stomatologjike me aparaturë përcjellëse;

1.3.2. Orman për instrumente dhe materialin tjetër.

1.4 Instrumentet e ordinancës:

1.4.1 Mbajtës të pasqyrave me pasqyrë stomatologjike;

1.4.2 Sonda;

1.4.3 Pinceta të lakuara;

1.4.4 Pinceta të drejta;

- 1.4.5 Instrumente për modelimin e mbushjeve;
 - 1.4.6 Ekskavator;
 - 1.4.7 Sonda paradontale;
 - 1.4.8 Shpatull për përzierje;
 - 1.4.9 Kova e gomës;
 - 1.4.10 Lopatëza për përzierje;
 - 1.4.11 Pllakëza të qelqit;
 - 1.4.12 Kireta;
 - 1.4.13 Seti për nxjerrjen e dhëmbëve;
 - 1.4.14 Pean;
 - 1.4.15 Mbajtës të gjilpërës kanalikulare;
 - 1.4.16 Pajisje dhe material për ndaljen e gjakderdhjes;
 - 1.4.17 Instrumentet për shërimin e kanalit të rrënjëve (endobox);
 - 1.4.18 Luge për marrje të masës;
 - 1.4.19 Enë për mbajtjen e vatës;
 - 1.4.20 Enë për mbajtjen e gjilpërave për konservativ (pllaka e Petrit);
 - 1.4.21 Enë për vendosjen e frezave;
 - 1.4.22 Rentgenit retroalveolar digjital.
- 1.5 Personeli:
- 1.5.1 Doktor i Stomatologjisë/ Specialist i lëmisë përkatëse të Stomatologjisë.
 - 1.5.2 Infermier/teknik mjekësor nga profilet e kësaj lëmie;
 - 1.5.3 Certifikata për përdorim të Oksidulit të Azotit*

Neni 22 **Ergoterapi**

1.Ambulanca e ergoterapisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Hapësira për punë me shfrytëzuesit e shërbimeve duhet të jenë të izoluara nga zëri, e ndriçuar me dritë natyrale dhe të mund të ajroset shpejt dhe efikas;

1.1.3 Në secilin hapësirë gjatë një ndërrimi (punë e drejtpërdrejtë me pacient) mund të punoj vetëm një ergoterapeut.

1.2 Paisjet e detyruara teknike dhe pajisjet tjera:

1.2.1 Tavolinë e punës dhe karrigë për ergoterapeutin dhe shfrytëzuesin e shërbimeve ergoterapeutike;

1.2.2 Pajisja terapeutike ndihmëse, adaptive dhe pajisjet tjera për diagnostikë dhe terapi;

1.2.3 Dollap për dokumente dhe pajisjet për diagnostikë dhe pajisjet për ruajtjen në siguri të plotë;

1.2.4 PC (Kompjuter), programe softëare ergoterapeutike;

1.2.5 Pasqyrë;

1.2.6 Telefon;

1.2.7 Lidhje interneti;

1.2.8 Kamera digjitale;

2. Personeli;

2.1 Ergoterapeut.

Neni 23 Ambulancë specialistike kirurgjike

1.Ambulanca specialistike kirurgjike përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermier/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barna dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matje të temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Shpatulla për një përdorim;

1.3.5 Dorëza për një përdorim dhe dorëza sterile;

1.3.6 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.7 Peshore;

1.3.8 Matës të gjatësisë;

1.3.9 Enë metalike;

1.3.10 Enë metalike me kapak për instrumente;

1.3.11 Enë metalike me kapak për tamponë;

1.3.12 Veshkore;

1.3.13 Negatoskop;

1.3.14 Boca me oksigjen;

1.3.15 Llambë tavoline;

1.3.16 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.17 Llambë të dorës me bateri;

1.3.18 Glikometër;

1.3.19 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.20 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.21 Telefon;

1.3.22 Frigorifer;

1.3.23 Mbajtës infuzioni;

1.3.24 EKG;

1.3.25 Defribilator;

1.3.26 Pulsoksimetër;

1.3.27 Aparat për sterilizim;

1.3.28 Mjete për imobilizim të përkohshëm;

1.3.29 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenim.

1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Komplet i me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve kirurgjike vetëm me anestezi lokal;

1.4.2 Tavolina për intervenime të vogla kirurgjike;

1.4.3 Sonda nazogastrike;

1.4.4 Kateter urinar;

1.4.5 Pajisje për punkcion;

1.4.6 Pajisje për bllokadë lokale;

1.4.7 Pajisje për anestezi lokal;

1.4.8 Aspirator;

1.4.9 Mbajtësin e gjuhës;

1.4.10 Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike, me sistem të mbyllur;

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialist, subspecialist i kirurgjisë (specialist nga profilet e kësaj lëmie);

1.5.2 Infermier/teknik mjekësor.

Neni 24 **Ambulancë specialistike e ortopedisë**

1.Ambulanca specialistike e ortopedisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezi lokal hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermier/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrige për mjekun;

1.2.5 Karrige për infermier/teknikun mjekësor;

1.2.6 Karrige pa mbështetëse për pacientin;

1.2.7 Varëse për rroba;

1.2.8 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.9 Paravan;

1.2.10 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.11 Tavolinën për instrumente;

1.2.12 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera;

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Dorëza për një përdorim dhe dorëza sterile;

1.3.5 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.6 Peshore;

1.3.7 Matës të gjatësisë;

1.3.8 Enë metalike;

1.3.9 Enë metalike me kapak për instrumente;

1.3.10 Enë metalike me kapak për tamponë;

1.3.11 Veshkore;

1.3.12 Negatoskop;

1.3.13 Boca me oksigjen;

1.3.14 Llambë tavoline;

1.3.15 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.16 Llampë të dorës me bateri;

1.3.17 Glikometër;

1.3.18 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.19 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.20 Telefon;

1.3.21 Aparat për sterilizim;

1.3.22 Frigorifer;

1.3.23 Mbajtës infuzioni;

1.3.24 Mjete për imobilizim të përkohshëm;

1.3.25 EKG;

1.3.26 Defribilator;

1.3.27 Pulsoksimetër;

1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Komploti me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-ortopedike vetëm me anestezion lokal;

1.4.2 Tavolinë për intervenime të vogla kirurgjike;

1.4.3 Pajisje për anestezion lokal;

1.4.4 Pajisje për matjet ortopedike;

1.4.5 Pajisje për punkSION;

1.4.6 Pajisje për bllokadë lokale;

1.4.7 Pajisje për vendosjen dhe largimin e gipsit;

1.4.8 Splinta të dimensioneve të ndryshme.

1.4.9 Rentgenit retroalveolar digjital;

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialist i Ortopedisë, traumatologjisë, specialist i ortoprdisë - pediatrike;

1.5.2 Infermier/teknik mjekësor.

Neni 25
Ambulancë specialistike e urologjisë

1. Ambulanca specialistike e urologjisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varrëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Dorëza dhe maska për një përdorim dhe dorëza sterile;

1.3.5 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.6 Peshore;

1.3.7 Matës të gjatësisë;

1.3.8 Enë metalike;

1.3.9 Enë metalike me kapak për instrumente;

1.3.10 Enë metalike me kapak për tamponë;

1.3.11 Veshkore;

1.3.12 Negatoskop;

1.3.13 13 Boca me oksigjen;

1.3.14 Dritë tavoline;

1.3.15 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.16 Llampë të dorës me bateri;

1.3.17 Glikometër;

1.3.18 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.19 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.20 Telefon;

1.3.21 Frigorifer;

1.3.22 Mbajtës infuzioni;

1.3.23 EKG;

1.3.24 Defribilator;

1.3.25 Pulsoksimetër;

1.3.26 Aparat për sterilizim;

1.3.27 Aparat Ultrazëri*;

1.3.28 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.

1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Komplet me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-urologjike vetëm me anestezi lokal;

1.4.2 Tavolinë për intervenime të vogla kirurgjike;

1.4.3 Pajisje për anestezi lokal;

1.4.4 Pajisje për punkcionin e fshikëzës urinare;

1.4.5 Komplet të kateterëve urinar me dimensione të ndryshme për një përdorim;

1.4.6 Cistoskop;

1.4.7 Dilatator;

1.4.8 Irigator;

1.4.9 Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike, me sistem të mbyllur.

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialist i Urologjisë;

1.5.2 Infermier/teknik mjekësor.

Neni 26
Ambulancë specialistike gjinekologjike

1. Ambulanca specialistike e gjinekologjisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Dorëza për një përdorim dhe dorëza sterile;

- 1.3.5 Fasha dhe gaza sterile;
- 1.3.6 Peshore;
- 1.3.7 Matës të gjatësisë;
- 1.3.8 Enë metalike;
- 1.3.9 Enë metalike me kapak për instrumente;
- 1.3.10 Enë metalike me kapak për tamponë;
- 1.3.11 Veshkore;
- 1.3.12 13 Boca me oksigjen;
- 1.3.13 Llambë tavoline;
- 1.3.14 Thjerrëz zmadhuese;
- 1.3.15 Llampë të dorës me bateri;
- 1.3.16 Glikometër;
- 1.3.17 Lidhësen e Esmarch-ut;
- 1.3.18 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;
- 1.3.19 Telefon;
- 1.3.20 Aparat për sterilizim;
- 1.3.21 Aparat për ultrazë*;
- 1.3.22 Frigorifer;
- 1.3.23 Mbajtës infuzioni;
- 1.3.24 EKG;
- 1.3.25 Defribilator;
- 1.3.26 Pulsoksimetër;
- 1.3.27 Negatoskop;
- 1.3.28 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.
- 1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Komplet me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-gjinekologjike, vetëm nën anestezion lokal;

1.4.2 Karrige për vizita gjinekologjike;

1.4.3 Burim drite artificiale për ekzaminim;

1.4.4 Spekulume vaginal për një përdorim;

1.4.5 Pajisje për marrjen e strishove vagjinale dhe cervikale;

1.4.6 Pajisje për anestezion lokal;

1.4.7 Pelvimetër;

1.4.8 Irigator;

1.4.9 Fetoskop;

1.4.10 Komplet të katetërëve urinar me dimensione të ndryshme për një përdorim;

1.4.11 Pajisje për marrjen e PAP-tesit dhe përcaktimit të shkallës së pastërtisë;

1.4.12 Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike me sistem të mbyllur;

1.4.13 Pelvimetr;

1.4.14 Spekulumet vaginale të ndryshme;

1.4.15 Danat për Cerviks dhe Uterus;

1.4.16 Pajisjet për fiksime dhe dërgim në citologji.

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialist i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës;

1.5.2 Infermier/teknik mjekësor nga profilet e kësaj lëmie.

Neni 27

Ambulancë specialistike e otorinolaringologjisë

1. Ambulanca specialistike e otorinolaringologjisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1. 2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermier/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun;

1.2.5 Karrigë për infermier/teknik mjekësor;

1.2.6 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.7 Varëse për rroba;

1.2.8 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.9 Paravan;

1.2.10 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.11 Tavolinë për instrumente;

1.2.12 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Shpatulla për një përdorim;

1.3.5 Dorëza dhe maska për një përdorim dhe dorëza sterile;

1.3.6 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.7 Peshore;

1.3.8 Matës të gjatësisë;

1.3.9 Enë metalike;

- 1.3.10 Enë metalike me kapak për instrumente;
- 1.3.11 Enë metalike me kapak për tamponë;
- 1.3.12 Veshkore;
- 1.3.13 Negatoskop;
- 1.3.14 13 Boca me oksigjen;
- 1.3.15 Llambë tavoline;
- 1.3.16 Thjerrëz zmadhuese;
- 1.3.17 Llampë të dorës me bateri;
- 1.3.18 Glikometer;
- 1.3.19 Lidhësen e Esmarch-ut;
- 1.3.20 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;
- 1.3.21 Telefon;
- 1.3.22 Otoskop;
- 1.3.23 Pasqyrë e ballit;
- 1.3.24 Aparat për sterilizim;
- 1.3.25 Frigorifer;
- 1.3.26 Mbajtës infuzioni;
- 1.3.27 Hapësin e gojës;
- 1.3.28 EKG;
- 1.3.29 Defribilator;
- 1.3.30 Pulsoksimetër;
- 1.3.31 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.

1.4. Pajisjet specifike:

- 1.4.1 Komplet i instrumenteve për ORL-së;
- 1.4.2 Komplet me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike në lëmin e ORL-së vetëm nën anestezion lokal;

- 1.4.3 Tavolinë për intervenime të vogla kirurgjike;
- 1.4.4 Pajisjen për anestezion lokal;
- 1.4.5 Inhalator;
- 1.4.6 Mbajtës i gjuhës;
- 1.4.7 Spekulumi për zgavrat e hundës;
- 1.4.8 Shiringë apo aparat për shpëlarjen e veshëve;
- 1.4.9 Aspirator;
- 1.4.10 Pajisje për marrjen e strishës së hundës, veshit, fytit;
- 1.4.11 Pirun akustik;
- 1.4.12 Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike.
- 1.5 Personeli:
- 1.5.1 Specialist i Otorinolaringologjisë;
- 1.5.2 Infermier/teknik mjekësor.

Neni 28

Ambulancë specialistike e oftalmologjisë/shërbim optik

1. Ambulanca specialistike e oftalmologjisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

- 1.1 Hapësira:
 - 1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;
 - 1.1.2 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².
- 1.2 Inventar:
 - 1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;
 - 1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;
 - 1.2.3 Kompjuter;
 - 1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;

- 1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;
- 1.2.6 Varëse për rroba;
- 1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;
- 1.2.8 Paravan;
- 1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;
- 1.2.10 Tavolinë për instrumente;
- 1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.
- 1.3 Pajisja bazike:
 - 1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);
 - 1.3.2 Stetoskop;
 - 1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;
 - 1.3.4 Dorëza dhe maska për një përdorim dhe dorëza sterile;
 - 1.3.5 Fasha dhe gaza sterile;
 - 1.3.6 Peshore;
 - 1.3.7 Matës të gjatësisë;
 - 1.3.8 Enë metalike;
 - 1.3.9 Enë metalike me kapak për instrumente;
 - 1.3.10 Enë metalike me kapak për tamponë;
 - 1.3.11 Veshkore;
 - 1.3.12 Boca me oksigjen;
 - 1.3.13 Llambë tavoline;
 - 1.3.14 Thjerrëz zmadhuese;
 - 1.3.15 Llampë të dorës me bateri;
 - 1.3.16 Glikometër;
 - 1.3.17 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.18 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.19 Telefon;

1.3.20 Frigorifer;

1.3.21 Mbajtës infuzioni;

1.3.22 Aparat për sterilizim;

1.3.23 Defribilator;

1.3.24 Pulsoksimetër;

1.3.25 EKG

1.3.26 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.

1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Tabelë për testimin e mprehtësisë së të pamurit dhe dallimin e ngjyrave;

1.4.2 Oftalmoskop;

1.4.3 Bio-mikroskop;

1.4.4 Skijaskop me ZHAVALL ose aparat i Autokeratorefraktometrit;

1.4.5 Tonometri sipas Schiozit ose Tonometri Aplanativ;

1.4.6 Thjerrëz zmadhuese;

1.4.7 Pajisje për shpëlarjen e syrit;

1.4.8 Pajisjen për intervenime të vogla kirurgjike-okulistike vetëm me anestezion lokal;

1.4.9 Tavolinë për intervenime të vogla kirurgjike.

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialist i Oftalmologjisë;

1.5.2 Infermier/teknik mjekësor

1.5.3 opticien/optometristë*.

Neni 29
Ambulancë specialistike e Fiziatriisë

1. Ambulanca specialistike e fiziatriisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermier/teknik mjekësor;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Dorëza dhe maska për një përdorim;

1.3.5 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.6 Peshore;

1.3.7 Matës të gjatësisë;

- 1.3.8 Enë metalike;
- 1.3.9 Enët metalike me kapak për instrumente;
- 1.3.10 Enë metalike me kapak për tamponë;
- 1.3.11 Negatoskop;
- 1.3.12 Boca me oksigjen;
- 1.3.13 Llambë tavoline;
- 1.3.14 Thjerrëz zmadhuese;
- 1.3.15 Llampë të dorës me bateri;
- 1.3.16 Glikometër;
- 1.3.17 Lidhësen e Esmarch-ut;
- 1.3.18 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;
- 1.3.19 Telefon;
- 1.3.20 Frigorifer;
- 1.3.21 Mbajtës infuzion;
- 1.3.22 Mjete për imobilizim të përkohshëm;
- 1.3.23 EKG;
- 1.3.24 Defribilator;
- 1.3.25 Pulsoksimetër;
- 1.3.26 Veshkore;
- 1.3.27 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.
- 1.4 Pajisja Specifike:
 - 1.4.1 Çekan;
 - 1.4.2 Metër;
 - 1.4.3 Këndmatës;
 - 1.4.4 Dinamometër;

1.4.5 Libelë;

1.4.6 Lavjerrës;

1.4.7 Shtrat për ekzaminim.

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialisti i Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim;

1.5.2 Teknik i fizioterapisë/teknik mjekësor/infermier.

Neni 30

Ambulancë specialistike e Fiziatriisë me terapi fizikale

1. Ambulanca specialistike e fiziatriisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Hapësirë për ushtrimin e veprimtarisë së terapisë fizikale së paku 35m², ashtu që gjatësia dhe gjerësia të mos jenë më pak se 4m²;

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermier/teknik mjekësor;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Dorëza për një përdorim;

1.3.5 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.6 Peshore;

1.3.7 Matës të gjatësisë;

1.3.8 Enë metalike;

1.3.9 Enët metalike me kapak për instrumente;

1.3.10 Enë metalike me kapak për tamponë;

1.3.11 Negatoskop;

1.3.12 Boca me oksigjen;

1.3.13 Llambë tavoline;

1.3.14 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.15 Llampë të dorës me bateri;

1.3.16 Glikometër;

1.3.17 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.18 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.19 Telefon;

1.3.20 Frigorifer;

1.3.21 Mbajtës infuzion;

1.3.22 Mjete për imobilizim të përkohshëm;

1.3.23 EKG;

1.3.24 Defribilator;

1.3.25 Pulsoksimetër;

1.3.26 Veshkore;

1.3.27 Çantë e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.

1.4 Pajisja Specifike:

1.4.1 Çekan;

1.4.2 Metër;

1.4.3 Këndmatës;

1.4.4 Dinamometër;

1.4.5 Libelë;

1.4.6 Lavjerrës;

1.4.7 Shtrat për ekzaminim.

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialisti i Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim;

1.5.2 Bachelor i fizioterapisë;

1.5.3 Teknik i fizioterapisë/teknik mjekësor/infermier*.

Neni 31

Ambulancë specialistike e sëmundjeve ngjitëse

1.Ambulanca specialistike e sëmundjeve ngjitëse përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulancat ku trajtohen pacientët me sëmundje ngjitëse të diagnostikuar, të siguroj hapësirën e vecantë prej së paku 12m²;

1.1.3 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

- 1.2.3 Kompjuter;
- 1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;
- 1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;
- 1.2.6 Varëse për rroba;
- 1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;
- 1.2.8 Paravan;
- 1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;
- 1.2.10 Tavolinë për instrumente;
- 1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.
- 1.2.12 Termometër për matjen e temperaturës trupore (së paku 2 copë);
- 1.2.13 Stetoskop;
- 1.2.14 Matës të shtypjes së gjakut;
- 1.2.15 Shpatulla për një përdorim;
- 1.2.16 Dorëza për një përdorim dhe dorëza sterile;
- 1.2.17 Fasha dhe gaza;
- 1.2.18 Peshore;
- 1.2.19 Matës të gjatësisë;
- 1.2.20 Enë metalike;
- 1.2.21 Enë metalike me kapak për instrumente;
- 1.2.22 Enë metalike me kapak për tamponë;
- 1.2.23 Veshkore;
- 1.2.24 Negatoskop;
- 1.2.25 Boca me oksigjen;
- 1.2.26 Llambë tavoline;
- 1.2.27 Thjerrëz zmadhuese;

1.2.28 Llampë të dorës me bateri;

1.2.29 Glikometër;

1.2.30 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.2.31 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.2.32 Telefon;

1.2.33 Aparat për sterilizim;

1.2.34 Frigorifer;

1.2.35 Mbajtës infuzioni;

1.2.36 Hapësin e gojës;

1.2.37 EKG;

1.2.38 Defribilator;

1.2.39 Pulsoksimetër;

1.2.40 Peakfloëmetër;

1.2.41 Otoskop;

1.2.42 Pasqyrë e ballit;

1.2.43 Inhalator;

1.3 Pajisjet specifike:

1.3.1 Pasqyrë për ekzaminimin e laringut;

1.3.2 Pajisje për punktion lumbal;

1.3.3 Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike, me sistem të mbyllur.

1.4 Personeli:

1.4.1 Specialist i sëmundjeve ngjitëse apo sub-specialist nga profilet e kësaj lëmie;

1.4.2 Infermiere/teknik mjekësor.

Neni 32

Ambulancë specialistike e pulmologjisë

1.Ambulanca specialistike e pulmologjisë përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës të ketë sipërfaqe prej së paku 12m²;

1.1.2 Ambulancat ku trajtohen pacientët me sëmundje ngjitëse të diagnostikuar, të siguroj hapësirën e veçantë prej së paku 12m²;

1.1.3 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal, hapësirë të veçantë prej së paku 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinë për instrumente;

1.2.11 Shportë metalikepër mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike:

1.3.1 Termometër për matjen e temperaturës se trupit (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Shpatulla për një përdorim;

1.3.5 Dorëza dhe maskapër një përdorim dhe dorëza sterile;

1.3.6 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.7 Peshore;

1.3.8 Matës të gjatësisë;

1.3.9 Enë metalike;

1.3.10 Enët metalike me kapak për instrumente;

1.3.11 Enë metalike me kapak për tamponë;

1.3.12 Veshkore;

1.3.13 Negatoskop;

1.3.14 Boca me oksigjen;

1.3.15 Llambë tavoline;

1.3.16 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.17 Llampë të dorës me bateri;

1.3.18 Glikometër;

1.3.19 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.20 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.21 Telefon;

1.3.22 Aparat për sterilizim;

1.3.23 Frigorifer;

1.3.24 Mbajtës infuzioni;

1.3.25 Hapësin e gojës;

1.3.26 EKG;

1.3.27 Defribilator;

1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Aspirator;

1.4.2 Pajisje për punkSION torakal dhe drenazh;

1.4.3 Spirometër;

1.4.4 Kompresa;

1.4.5 Peakfloëmetër;

1.4.6 Inhalator;

1.4.7 Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjie, biokimike dhe mikrobiologjike me sistem të mbyllur;

1.5 Personeli:

1.5.1 Specialist i Pulmologjisë;

1.5.2 Infermier/teknik mjekësor.

Neni 33

Ambulancë specialistike e alergologjisë me imunologji klinike

1. Ambulanca specialistike e alergologjisë me imunologji klinike përveç kushteve të përcaktuara në nenin 18, obligohet të plotësojë edhe këto kushte:

1.1 Hapësira:

1.1.1 Hapësira e ambulancës së paku 12m² ;

1.1.2 Hapësira për marrjen e mostrave prej 12m².

1.2 Inventar:

1.2.1 Tavolinë e punës për mjekun;

1.2.2 Tavolinë e punës për infermiere/teknikun mjekësor;

1.2.3 Kompjuter;

1.2.4 Karrigë për mjekun dhe infermieren;

1.2.5 Karrigë pa mbështetëse për pacientin;

1.2.6 Varëse për rroba;

1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;

1.2.8 Paravan;

1.2.9 Dollap për barëra dhe instrumente;

1.2.10 Tavolinën për instrumente;

1.2.11 Shportë metalike për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera.

1.3 Pajisja bazike;

1.3.1 Termometër (së paku 2 copë);

1.3.2 Stetoskop;

1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;

1.3.4 Shpatulla për një përdorim;

1.3.5 Dorëza për një përdorim dhe dorëza sterile;

1.3.6 Fasha dhe gaza sterile;

1.3.7 Peshore;

1.3.8 Matës të gjatësisë;

1.3.9 Boca me oksigjen;

1.3.10 Llambë tavoline;

1.3.11 Thjerrëz zmadhuese;

1.3.12 Llampë të dorës me bateri;

1.3.13 Glikometër;

1.3.14 Lidhësen e Esmarch-ut;

1.3.15 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;

1.3.16 Telefon;

1.3.17 Pulsoksimetër;

1.3.18 Peakfloëmetër;

1.3.19 Aparat për sterilizim;

1.3.20 Frigorifer;

1.3.21 Mbajtës infuzioni;

1.3.22 EKG;

1.3.23 Defribilator;

1.3.24 Veshkore;

1.3.25 Negatoskop;

1.4 Pajisjet specifike:

1.4.1 Inhalator

1.4.2 Mikropipeta;

1.4.3 Epruveta;

1.4.4 Teste për IgE specifike;

1.4.5 mbajtës të epruvetave;

1.4.6 Termostat;

1.5 Ambulanca Specialistike e Alergologjisë me Imunologji Klinike për kryerjen e testeve serologjike për SARS-CoV-2 përveç pajisjeve bazike dhe hapësirës duhet të plotësojë edhe këto:

1.5.1 Imunoanalizatori, ose ELISA (shpërlarësi, lexuesi) ose mikroskopi imunofluoroshentë;

1.5.2 Pipeta të madhësive të ndryshme;

1.5.3 Autokllavi;

1.5.4 Ambulanca duhet të ketë hapësirë të veçantë dhe adekuate për të vendosur pajisjet dhe materialin për kryerjen e testimit serologjik, bazuar në praktikat dhe procedurat e mira laboratorike.

1.6 Personeli:

